



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 01.06.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.05.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Bashkimi&Meti" për aktivitetin: "Ndertimi i rruges nga Flotacioni lagja Vakovc" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1262-511 nxjerr:

### V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Bashkimi&Meti" e datës 28.05.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit " **Ndertimi i rruges nga Flotacioni lagja Vakovc**" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1262-511, kundër *Njoftimit për kontrate e AK-se te datës 29.04.2020*, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. Vërtetohet Njoftimi për kontrate e Autoritetit Kontraktues të datës 29.04.2020;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**Bashkimi&Meti**" me datë 28.05.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i rruges nga Flotacioni lagja Vakovc" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1262-511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 01.06.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Kërkesa e OE-ik , është parashtruar pas afatit te fundit te përcaktuar ne piken 16.1 te FTD-së.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

